



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISE KORÇE

VENDIM

Nr 48 date 25.08.2011

“Per nje ndryshim ne kontraten per Master – Planin e Qendres se qytetit Korçe”

Keshilli i Bashkise Korçe pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe bazuar në nenin te nenit 8/6/a,10/1/g dhe 32/k,te ligjit 8652, date 31.07.2000 “Per Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, VKB nr.43 dt 10.04.2009 “Per miratimin e detyres se projektimit dhe platformes se konkursit se qendres se qytetit te Korçes” dhe kontrates te dates 9.11.2009 te lidhur midis Bashkise Korçe dhe Studios Gjermane te projektimit BOLLES + WILLSON dhe mbas diskutimeve te Keshilltareve

VENDOSI

1. Te miratoje ndryshimin e nenit 6.3.c te kontrates **nga** “Nje pagese e trete prej 40% do te behet pas miratimit te Masterplanit Final dhe Raporteve perfundimtare te Shesheve dhe te Zones Kembesore, nga Klienti, Bashkia Korçe” **ne** “Pagesa e keshtit te trete te kontrates ne masen 40% te saj do te behet pas dorezimit prane Bashkise Korçe, nga ana e Konsulentit te Raportit Final te Masterplanit si dhe Raporteve Finale te Zones Kembesore , Sheshit te Teatrit dhe Sheshit te Katedrales.”
2. Te autorizojë Kryetarin e Bashkise te nenshkruajë kontraten shtese qe do te kete objekt ndryshimin e nenit 6.3.c te kontrates baze.

3. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike.
4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETAR

ILIRJAN PENDAVINJI



Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP
www.infocip.org